



PANDEMIA DHE SFIDAT E RIMËKËMBJES EKONOMIKE TË KOSOVËS



DONATORËT



QEVERIA E KOSOVËS



AGJENCIA AMERIKANE PËR
ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
(USAID)



BANKA GJERMANE PËR ZHVILLIM
(KfW)

BASHKËPUNËTORËT



AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (SIDA)



BANKA BOTËRORE (BB)



FONDI EVROPIAN I INVESTIMEVE (EIF)



MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO

FONDACIONI KOSOVAR I MILENIUMIT (MFK)

INSTITUCIONET FINANCIARE PARTNERE



Opinionet, mendimet dhe analizat e shprehura përmes artikujve të botuar nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimet e FKGK-së apo qasjen e Institucionit ndaj të njejtave.

PËRMBAJTJA



- 04 Parathënie nga Kryesuesi i Bordit të FKGK-së
 - 06 Pandemia dhe sfidat e rimëkëmbjes ekonomike të Kosovës
 - 09 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore – vlerë e shtuar për sistemin financiar
 - 11 Sektori bankar në kohë pandemie: Një reagim i balancuar i bankave komerciale
 - 13 Lehtësimi i pasojave ekonomike të pandemisë përmes legjislacionit
 - 16 A do të ngadhënjejë buxheti i Kosovës mbi krizën ekonomike të shkaktuar nga COVID-19?
 - 18 Platforma Agrosoft dhe roli i saj në mbështetjen e sektorit të bujqësisë
-
- 20 **STORIE SUKSESI**
HIT FLORES - Një qendër grumbulluese në Malet e Sharrit

ARBËRIA GROUP - prodhuese e ujit natyral mineral “Ujë i Alpeve”
-
- 22 **KËNDI I LAJMEVE 2020**
FKGK dhe MFK së bashku për të mbështetur investimet në energjinë e ripërtërishme solare
 - 22 Nënshkruhet marrëveshja financiare për rritje të kapitalit garantues të FKGK-së
 - 22 Nënshkruhet marrëveshja për ndihmë ndërmjet MF-së dhe FKGK-së
 - 23 MFK, FKGK dhe MF nënshkruajnë letërën e qëllimit
 - 23 Nënshkruhet marrëveshja financiare për Rritje të Kapitalit Garantues për FKGK
 - 23 Implementimi i Projektit të Bankës Botërore për Fuqizimin e Sektorit Financiar në Kosovë
 - 24 Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike
 - 24 FKGK prezanton rolin e tij institucional në zhvillimin ekonomik të vendit
 - 24 FKGK e merr pjesë në forumin virtual të organizuar nga AmCham
 - 25 FKGK organizon takim koordinues me donatorët dhe partnerët e vet
 - 25 Lansohet Platforma AgroSoft nga FKGK
 - 25 FKGK pjesë e Edicionit të tretë të Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kosovës
 - 26 Trajnimi për ngritje të njohurive institucionale për ER dhe EE
 - 26 Trajnimi për përdorimin e platformës Agrosoft
 - 27 FKGK pjesë e Konventës Vjetore të Shoqatës së Bankave të Kosovës 2020, “Bankimi në Kohën e COVID-19”
 - 27 Vendndodhja e re e FKGK-së

PARATHËNIE NGA KRYESUESI I BORDIT TË FKGK-SË

Të nderuar lexues,

Falë punës se palodhshme të kolegëve nga institucioni i FKGK-së, të cilët përkundër sfidave të shkaktuara nga pandemia e COVID-19, kanë gjetur motivin dhe vullnetin të kontribuojnë në zhvillimin e idesë dhe lançimin e buletinit të FKGK-së, sot kemi kënaqësinë të prezantojmë edicionin e parë të buletinit informativ të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë.

I menduar të publikohet rregullisht çdo gjashtë muaj, ky buletin synon rritjen e transparencës për publikun, lidhur me aktivitetet e institucionit tonë, si dhe do të orvatet të përmbledhë opinionet nga mendjet më aktuale në shoqërinë kosovare, për tema të caktuara ekonomike dhe financiare, që do të përzgjedhen të trajtohen, varësisht nga aktualiteti, brenda një periudhe të caktuar kohore.

Prandaj, si kryesues i Bordit të Drejtorëve, kam nderin dhe kënaqësinë që me këtë shkrim të hap edicionin e parë të Revistës së FKGK-së, ndërsa kësaj radhe s'do mend që tema më aktuale që kemi përzgjedhur për trajtim është efekti i krizës së shkaktuar nga pandemia e COVID-19 në ekonominë e Kosovës, si dhe roli që FKGK-ja do të luajë në procesin e rimëkëmbjes ekonomike.

Duke qenë institucion i themeluar me qëllimin për të mbështetur përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes për ndërmarrjet private në Kosovë, FKGK-ja si instrument financiar do të ketë rol aktiv në rigjallërimin e ekonomisë gjatë vitit të ardhshëm. Kthimi i besimit në sektorin bankar dhe luftimi i ngërçit potencial kreditor, që më pastaj do të përkeqësojë ciklin e likuiditetit brenda sektorit privat, është objektiva kryesore që do të duhej ta adresonte skema garantuese e FKGK-së, në periudhën gjatë dhe pas krizës së shkaktuar nga pandemia e COVID-19.



RINOR GJONBALAJ

Kryesues i Bordit të Drejtorëve
FKGK

Që nga ditët e hershme, kur në vendin tonë u paraqitën rastet e para të infeksionit me virusin SARS-CoV-2, dhe si rezultat Qeveria e Republikës së Kosovës prezantoi masat e para për të parandaluar përhapjen e pandemisë së COVID-19, strukturat qeverisëse të FKGK-së kanë ofruar të gjitha alternativat e mundshme për të vënë në dispozicion infrastrukturën dhe kapacitetet institucionale të FKGK-së, me të vetmin qëllim luftimin e impaktit negativ të shkaktuar nga kriza e pandemisë së COVID-19 në ekonominë e vendit tonë.

Krahas kësaj, përgjatë gjithë periudhës së pandemisë së COVID-19, kur ekonomia e Kosovës filloi të dobësohej, humbja e vendeve të punës ishte në një trend të paparë, ndërsa kërkesa e huamarrësve për të ristrukturuar obligimet kreditorë kishte kaluar 50% në nivel të sektorit bankar, FKGK-ja ka vazhduar të mbajë hapur dritaret ekzistuese garantuese, përkundër rritjes së perceptimit të riskut në treg dhe paparashikueshmërisë së rrjedhës së ngjarjeve në mbarë botën, mirëpo posaçërisht në vendit tonë. Sa për ilustrim,

vetëm gjatë periudhës mars-tetor, dritaret garantuese brenda FKGK-së kanë ofruar garanci për afërsisht 1200 ndërmarrje në vlerë kreditore prej më shumë se 40 milionë euro.

Po ashtu, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në grupet punuese të inicuar nga Ministria e Financave për dizajnimin e pakos së rimëkëmbjes ekonomike, FKGK-ja ka paraqitur vizionin se në ç' mënyrë instrumenti i skemës garantuese të FKGK-së do të mund të vihet më së miri në funksion të adresimit të pasojave të krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia e COVID-19 dhe sesi kjo skemë do të duhej t'i përshtatej situatës së sapokrijuar. Kthimi i besimit në sektorin bankar me qëllim të evitimit të ngërçit kreditor, që më pastaj do të sillte mungesën e likuiditetit në treg, është identifikuar si një nga frontet në të cilat do të duhej të luftojë FKGK-ja, gjatë dhe pas krizës së COVID-19. Për ta arritur këtë qëllim, në një situatë kur perceptimi i riskut kreditor në treg konsiderohet shumë më i lartë sesa në rrethana normale, është parë e nevojshme që skema garantuese e FKGK-së të ofrojë shkallë më të lartë të mbulueshmërisë me garanci. Prandaj, rritja e shkallës së garancisë kreditore, nga 50% sa ishte në 80%, u konsiderua si parakusht për të bërë ndryshim të ndjeshëm në treg. Në të njëjtën kohë, në koordinim të vazhdueshëm me komunitetin e biznesit, BQK-në dhe bankat partnere, u shfaq ambicia që kjo periudhë do të mund të shfrytëzohej edhe për të ndihmuar nisjen e riformatizimit të sektorit privat, duke iu krijuar mundësi më shumë segmenteve të caktuara të tregut që do të rrisnin aftësinë konkurruese të ekonomisë kosovare. Për këtë arsye u dizajnuan dritare të veçanta garantuese, që do të adresonin nevoja specifike të segmenteve të caktuara të tregut. Më konkretisht, me këtë synohej t'i ndihmohej sektorëve që konsideroheshin strategjikë për ekonominë, si dhe segmenteve të margjinalizuara në jetën e biznesit.

Ndërsa rritja e mbulueshmërisë kërkonte ndryshim-plotësimin e legjislacionin aktual që rregullon veprimtarinë e FKGK-së, gjë që varet nga politikë-bërësit, pjesa e dytë

e dizajnit të dritareve garantuese u bazua dhe u përgatit nga vetë strukturat e brendshme të FKGK-së. Para së gjithash, sinkronizimi i objektivave themelore të institucionit të FKGK-së, që pakoja të arrijë të sjellë ndryshim dhe shtueshmëri ekonomike në treg, ndërsa njëkohësisht të mos jetë instrument që promovon incentiva të gabuara në treg e që më pastaj do të rezultonin në praktika të papërgjegjshme të huadhënies, ishte dhe vazhdon të jetë sfidë në vete, jo vetëm për institucionin e FKGK-së, por edhe për rregullatorin dhe bankat partnere.



... vetëm gjatë periudhës mars-tetor, dritaret garantuese brenda FKGK-së kanë ofruar garanci për afërsisht 1200 ndërmarrje në vlerë kreditore prej më shumë se 40 milionë euro.

Sidoqoftë, mbesim me shpresën që së bashku me bankat partnere dhe me mbështetjen e vazhdueshme nga BQK-ja, ne do të mund t'i balancojmë si është më së miri këto dy objektiva dhe kjo pako do të korreë përfitimet më të mira që do t'i ndihmojnë ekonominë dhe sektorit privat.

Në fund fare, më lejoni që në emër të Bordit të Drejtorëve dhe të punonjësve të FKGK-së t'i shpreh falënderim të gjithë kontribuuesve që me shkrimet e tyre begatuan edicionin e parë të buletinit të FKGK-së. Njëherazi, të gjithëve ju dëshirojmë shëndet dhe urojmë që në edicionin e radhës të buletinit të mund të diskutojmë për sukseset e rimëkëmbjes së ekonomisë sonë dhe krijimin e mundësive të reja për ndërmarrësit kosovarë.

PANDEMIA DHE SFIDAT E RIMËKËMBJES EKONOMIKE TË KOSOVËS

Sikundër ekonomitë e vendeve tjera gjithandej globit edhe ekonomia e Kosovës është goditur rëndë nga pandemia e COVID-19. Për t'u përballur me këtë situatë të pazakontë, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë një sërë veprimesh të koordinuara me partnerët tanë zhvillimorë, me institucionet ndërkombëtare financiare dhe me hisedarët tjerë, përfshirë edhe komunitetin e biznesit.

Për shkak të rënies së ndjeshme të të hyrave, nga njëra anë, dhe të rritjes së konsiderueshme të shpenzimeve në menaxhimin e pandemisë, nga ana tjetër, Qeveria e Kosovës në muajin korrik 2020 ka bërë rishikimin e buxhetit, veprim ky i domosdoshëm për të reflektuar në buxhetin e shtetit trendin në rënie të të hyrave si pasojë e ngecjes së aktivitetit ekonomik, por edhe për të bërë rregullimet e nevojshme ligjore të cilat na kanë mundësuar ekzekutimin efikas të pagesave të prapambetura për qytetarët dhe bizneset. Menjëherë pas kësaj, kemi krijuar Programin për Rimëkëmbje Ekonomike (PRE) në shumë prej 365 milionë euro, dhe kemi hartuar Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19 i cili tashmë ka kaluar në leximin e parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

PRE-ja përfshin masa të rëndësishme të cilat synojnë zbutjen e pasojave socio-ekonomike të shkaktuara nga pandemia dhe që vendosin bazë solide për stimulimin e ekonomisë drejt rikthimit të saj në trend pozitiv. Masat e programit vendosin qytetarin dhe biznesin privat në qendër të planit të rimëkëmbjes. Plan operativ për zbatimin e PRE-së përcakton qartë veprimet institucionale, ndarjet buxhetore, kriteret për përfituesit, si dhe aktorët zbatues të secilës masë. PRE-ja është dizajnuar me qëllim që të integrohet plotësisht



HYKMETE BAJRAMI

Ministre e Financave

në Programin e Qeverisë 2020-2023 ku luftimi i pandemisë dhe rimëkëmbja socio-ekonomike përbëjnë shtyllat prioritare të politikave dhe investimeve tona. Plan i zbatimit siguron që masat të jetësohen me efikasitet dhe që investimet të prodhojnë efekte zinxhirore socio-ekonomike me qëllim që rimëkëmbja të fillojë më shpejt dhe të jetë e qëndrueshme.

Që të sigurohemi se askush nuk do të mbetet i papërfshirë apo i braktisur nga përkujdesja shtetërore në këtë periudhë të pasigurisë socio-ekonomike, ne kemi zbatuar parimin e gjithëpërfshirjes. Në këtë drejtim, kemi mbështetur sektorin privat me subvencione, lehtësira tatimore dhe përmirësim të qasjes në financa; kemi financuar sektorin e shëndetësisë për forcimin e kapaciteteve të përgjithshme në mënyrë që të përballojë pandeminë, por edhe të jetë rezilient në menaxhimin e krizave eventuale shëndetësore në planin afatgjatë; jemi përkujdesur për barazinë gjinore; kemi

ndarë fonde për rininë, kulturën, sportin, komunitetet, bujqit, pushtetin lokal, ekonominë e gjelbër, digjitalizimin e bizneseve, etj. Kemi rritur po ashtu financimin për familjet përfituese të skemës sociale.



...kemi krijuar Programin për Rimëkëmbje Ekonomike (PRE) në shumë prej 365 milionë euro, dhe kemi hartuar Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19.

Jemi angazhuar që procesi i zbatimit të PRE-së të jetë i koordinuar mirë; të kryhet në mënyrë transparente dhe në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e financave publike. Në këtë drejtim, kemi kultivuar dialog të hapur me përfaqësuesit e sektorit privat të cilët kanë ndihmuar Qeverinë me propozime dhe ide konkrete të cilat janë përfshirë në programin për rimëkëmbje – siç ishte masa e fundit e Qeverisë për ndarjen e shumës prej 60 milionë euro për bizneset – propozim ky i ardhur nga asociacionet e biznesit, nga e cila shumë po përfitojnë bizneset aktive të vendit sipas kriterëve të zërthyer mirë nga një komision ndërministror (për shembull: bizneset që kanë nga 1 deri në 50 punëtorë përfitojnë mbi 72% të mjeteve, ose ato me 1 deri në 100 punëtorë përfitojnë mbi 80% të kësaj shume).

Përkundër vështirësive dhe kufizimeve buxhetore, ne po angazhohemi që politikëbërja jonë për menaxhimin e pandemisë të mos shpërqendrohet nga vizioni ynë afatgjatë për përmbushjen e aspiratave për integrim në BE, përmes zbatimit të MSA-së dhe Agjendës Evropiane të Reformave, si dhe përmbushjen e objektivave tona në kuadër të Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Deficiti buxhetor, i krijuar për shkak të rritjes së shpenzimeve dhe rënies së të hyrave, po kompensohet përmes rritjes së borxhit publik, qoftë përmes kredive të buta nga institucionet financiare ndërkombëtare apo përmes emetimit të letrave me vlerë. Për këtë arsye, ne kemi ndryshuar rregullat fiskale duke krijuar bazën ligjore për akomodimin e rritjes së borxhit publik - i cili për fat të mirë ka qenë i ulët. Në këtë aspekt, jemi duke punuar ngushtë me FMN-në që të adoptojmë praktikën më të mira të menaxhimit të borxhit duke u siguruar që rritja e borxhit publik të vihet në funksion të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve të vendit tonë.


Vlen të potencohet se përkundër sfidave të krijuara nga kjo situatë e paprecedent, kohëzgjatja e së cilës do të përcaktohet nga zhvillimet epidemiologjike në periudhën vijuese, ne kemi arritur të ruajmë stabilitetin makrofiskal në vend dhe të intensifikojmë angazhimin tonë në avancimin e reformave në përmbushjen e synimeve tona për zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe integrim në BE.




FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

TË ARRITURAT NË 2020

KREDITË E MIRATUARA



KREDITË SIPAS SEKTORËVE



RRITJA E QARKULLIMIT

Deri më 31 tetor 2020

5,622

kredi për NMVM-të



parashohin

211.3 milionë euro

rritje të qarkullimit mbi bazën e tanishme të qarkullimit të NMVM-ve përkatëse.

FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE – VLERË E SHTUAR PËR SISTEMIN FINANCIAR

Fondet për garantimin e kredive së pari u krijuan në Evropë në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX. Fondet publike për garantimin e kredive janë një formë e intervenimit nga qeveria për të mundësuar qasjen në financa për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM). Tani më shumë se gjysma e vendeve të botës kanë themeluar fonde të tilla për të përkrahur NMVM-të. NMVM-të janë shumë të rëndësishme për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Në Kosovë, deri në vitin 2016 përkundër suksesit të madh që kishin treguar bankat dhe institucionet tjera financiare në zhvillimin ekonomik dhe financimin e ekonomisë, qasja në financa ishte ende e ulët. Një pjesë e NMVM-ve, sidomos NMVM-të në sektorin e bujqësisë, NMVM-të e reja dhe NMVM-të me pronare gra kishin vështirësi në financimin e aktiviteteve të tyre. Ky kufizim zakonisht ishte rezultat i kostos së lartë të interesit dhe kostove administrative që lidhen me huadhënien në shuma të ulëta, rrezikun e lartë kreditor të perceptuar të NMVM-ve, si dhe mungesën e kolateralit në posedim të NMVM-ve.

Duke e pasur parasysh këtë situatë, në fillim të vitit 2016, Qeveria e Kosovës së bashku me donatorët ndërkombëtarë, siç janë USAID-i dhe KfW-ja, krijuan Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK). FKGK-ja është një institucion i themeluar më ligj. Zakonisht për të filluar një fond për garantimin e kredive nevojitet ndihmë nga jashtë. FKGK-ja ishte me fat që kishte ndihmën e donatorëve të saj, veçanërisht USAID-i dhe KfW-ja, të cilët me donacionet e tyre kontribuan me pjesën më të madhe në kapitalin e Fondit. Brenda një kohe shumë të shkurtër, FKGK-ja nisi veprimtarinë dhe



FEHMI MEHMETI

Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës

filloi t'u shërbejë NMVM-ve në formën e garantimit të kredive deri në shumën 50%. Ndikimi i FKGK-së u vërejt shumë shpejt. Rritja vjetore e kreditimit pas fillimit të veprimtarisë së Fondit ishte dyshifrore dhe vazhdoi me këtë trend deri në fillim të vitit 2020 para pandemisë së COVID-19. Tashmë në Fond janë të regjistruara tetë banka, si dhe një institucion mikrofinanciar dhe besoj që edhe institucionet tjera të huadhënies do të regjistrohen në ndërkohë.

Rritja e qasjes në financim për NMVM-të ka rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës. BQK-ja si rregullator i sistemit financiar ka përmirësuar mjedisin e punës së FKGK-së dhe i ka bërë më tërheqëse për bankat garancitë e saj me qëllim të rritjes së aktivitetit kreditor në industrinë financiare. Një ndër veprimet e para që BQK-ja ndërmori për këtë qëllim ishte peshimi i pjesës së kredive të garantuara nga FKGK-ja për qëllime të llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit me 0%.

Kjo u mundësoi bankave lehtësime të kërkesave për mjaftueshmëri të kapitalit për të gjitha kreditë e garantuara nga FKGK-ja duke mundësuar rritjen e kreditimit dhe njëkohësisht rritjen e qasjes në financim.

Suksesi i FKGK-së është shumë i dukshëm. Deri me tani FKGK-ja ka stimuluar dhënien e kredive në vlerë prej 200 milionë euro duke garantuar 97 milionë euro prej tyre. Ky rezultat është mbresëlënës duke pasur parasysh kohën e shkurtër të operimit të fondit dhe, ç'është me e rëndësishmja, këto kredi ishin për NMVM-të të cilat kishin vështirësi në financimin e aktiviteteve të tyre. Si rezultat i këtij financimi të NMVM-ve, sipas vlerësimit të FKGK-së, u krijuan afro 8 mijë vende të reja të punës.

Pandemia e COVID-19 ka goditur ekonominë e Kosovës dhe njëkohësisht aktivitetin kreditor të bankave, si dhe mund të këtë ndikuar negativisht në aftësinë paguese të kreditorëve. Kjo situatë do të jetë një nga sfidat e radhës për FKGK-në, bankat komerciale dhe Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Kjo sfidë do të kalohet me një bashkëpunim të ngushtë të të gjithë akterëve, duke përfshirë Qeverinë e Kosovës, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Institucionet Financiare dhe FKGK-në. Bashkëpunimi ndërmjet këtyre institucioneve ka qenë dhe është i shkëlqyeshëm.

Rëniet ekonomike zakonisht rritin hendekun e financimit dhe atë jo vetëm për NMVM-të. Në periudha të rënies ekonomike oferta e kredisë është më e ulët për shkak të niveleve më të ulëta të kapitalit dhe likuiditetit të bankave. Gjithashtu, për shkak të pasigurisë së krijuar bankat mund të kufizojnë huadhënien. Në situata të tilla, shumë vende reagojnë duke rritur shumën dhe përqindjen e kredive të garantuara. Në Kosovë kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet FKGK-së. Në këtë realitet të ri që është krijuar, roli i FKGK-së është bërë edhe më i rëndësishëm për të nxitur rritjen e kreditimit që është

një nga parakushtet për rimëkëmbjen ekonomike. Rëndësia e FKGK-së tashmë është pranuar edhe në planin e hartuar për rimëkëmbjen ekonomike, i cili shpresojmë që do të gjejë përkrahje në Kuvendin e Kosovës.

Në këtë situatë, FKGK-së i duhet të shfrytëzojë mundësitë e reja të krijuara duke rritur pjesëmarrjen e garantimit të kredive për sektorët më pak të shërbyer dhe me rëndësi të madhe për rimëkëmbjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në këtë aspekt duhet ndihmuar më shumë NMVM-të me risk më të madh kreditor dhe duhet të zvogëlojë kostot e këtyre kredive.

FKGK-ja duhet gjithashtu t'i këtë me prioritet më të lartë NMVM-të të cilat mund të japin kontribut më të madh në rritjen ekonomike, siç janë ato eksportuese, novatore dhe prodhuese. Bizneset e reja qasjen në financim e kanë edhe më të vështirë se ato ekzistuese për shkak të mungesës së historikut të operimit. FKGK-ja duhet të krijojë dritare apo garanci të veçanta për të inkurajuar hapjen e bizneseve të reja duke e lehtësuar qasjen e tyre në financim nëpërmjet garantimit të kredive të tyre.

Një aspekt tjetër që do t'i mundësonte FKGK-së të përmirësojë qasjen në financim dhe të rritë shfrytëzimin e garancive është përmirësimi i kushteve të garancive lidhur me kohën e pagesës së humbjeve në rast të dështimit dhe mos të jetë medoemos pasi janë shterur të gjitha procedurat e përmbarimit dhe arkëtimit. Natyrisht, në rast të ndonjë rikuperimi pas pagesës, FKGK-ja do të mund të rimburshej për pjesën e saj.

FKGK-ja do të vazhdojë të luajë rol shumë të rëndësishëm, jo vetëm për zhvillimin ekonomik por edhe për rritjen e qëndrueshmërisë së këtij zhvillimi. E përgëzoj FKGK-në për kontributin e dhënë deri më tani dhe i uroj suksese në të ardhmen. BQK-ja do ta vazhdojë bashkëpunimin me FKGK-në me qëllim të rritjes së stabilitetit financiar dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

SEKTORI BANKAR NË KOHË PANDEMIE: NJË REAGIM I BALANCUAR I BANKAVE KOMERCIALE

Si rezultat i pandemisë globale të COVID-19, në mars të vitit 2020, Kosova si edhe vendet e tjera të botës, u ballafaquan papritur me krizë të rëndë shëndetësore. Me kufizimin e lëvizjes së popullatës dhe mbylljen e tërësishme ekonomike pësuan goditje, pothuajse, të gjithë sektorët e ekonomisë, duke përfshirë këtu edhe sektorin bankar në Kosovë. Kjo krizë shëndetësore së shpejti u shndërrua në një krizë të thellë ekonomike, ku Kosova pësoi rënien më të madhe ekonomike të regjistruar ndonjëherë në historikun e saj të ekonomisë së tregut të lirë. Sipas të dhënave të publikuara nga BQK-ja, rritja më e madhe vjetore që ka pasur Kosova që nga shpallja e pavarësisë ishte 4.37% në vitin 2011. Ndërsa, në TM2 të vitit 2020, BPV-ja në Kosovë pësoi tkurje prej -9.28%.




PETRIT BALIJA

Kryeshef Ekzekutiv
Shoqata e Bankave të Kosovës

KREDITIMI

Goditja ishte e madhe edhe në sektorin bankar meqë me mbylljen e ekonomisë dhe kufizimin e lëvizjes publike pati edhe një rënie të theksuar në kreditim. Rënia në kreditim ishte e thellë dhe të dhënat tregojnë se kreditimi ishte reduktuar në prill (-63%), në maj (-56.4%) dhe në qershor (-22.6%) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rrjedhimisht, sektori bankar kreditoi €191.8 milionë më pak në këta tre muaj në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Me fillimin e tërheqjes graduale të masave të kufizimit të lëvizjes dhe kufizimeve të shërbimeve nga bizneset, filloi edhe rritja e kreditimit duke rikuperuar kështu një pjesë të kreditimit të mangët në


periudhën e lartcekur. Kreditimi në vijim tejkaloi madje pritjet e përgjithshme dhe në fakt tejkaloi volumin e kredive të reja të dhëna në vitin paraprak si në vijim: korrik (+14.4%), gusht (+35%). Kjo rritje në kreditim sigurisht që mund t'i atribuohet edhe efektit të kompensimit për muajt paraprakë. Bankat u treguan vigjilente për të mos shpërfillur kërkesat për financim nga ekonomitë familjare dhe bizneset dhe nuk u bazuan në zhvillimet prociklike ekonomike, duke mundësuar kështu likuiditet më të lartë dhe duke parandaluar një krizë të kreditimit. Kjo i shërbeu ekonomisë vendore mjaft mirë, kur dihet se ofrimi i likuiditetit përmes kreditimit është me rëndësi të veçantë për rimëkëmbjen ekonomike.



KREDITË SIPAS SEKTORËVE EKONOMIKË

Përqindja e kredive sipas sektorëve vazhdoi të mbetet relativisht e njëjtë me vitet e kaluara me një dallim te sektori i bujqësisë, i cili shënoi rënie prej -1% (15 milionë euro) në pjesëmarrje në portofolin kreditor dhe një rritje e lehtë u

pa te sektori i ndërtimtarisë duke shënuar rritje prej +2.2% (50 milionë euro). Duke pasur parasysh strukturën ekonomike të vendit, por edhe faktin që pandemia nuk e ka goditur shumë sektorin e tregtisë, shihet se edhe më tutje ky sektor ka përqindjen më të lartë të pjesëmarrjes në portofolin kreditor me 44.1% .




NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT PËR KREDI

Normat e interesit për kredi kanë vazhduar të shënojnë rënie edhe gjatë vitit 2020. Në fund të vitit 2019, norma mesatare efektive e interesit për kredi ishte 6.42%, ndërsa në fund të muajit gusht 2020, kjo normë shënoi 6.07%, ndërsa te normat e interesit për biznese u shënuua niveli më i ulët i normës mesatare të interesit gjegjësisht 5.93%. Normat e interesit në Kosovë vazhdojnë të mbeten në mesataren e rajonit dhe kanë trend të rënies.

KREDITË JOPERFORMUESE

Një nga paqartësitë më të mëdha në këtë situatë është çështja e kredive joperformuese (KJP). Sektori bankar në Kosovë ka hyrë në këtë pandemi me një normë të ulët të KJP-ve prej vetëm 2.5% në shkurt të vitit 2020. Kjo i ka mundësuar bankave komerciale një hapësirë të mjaftueshme për reagim. Megjithatë, paqartësia rrjedh nga fakti që një pjesë e rregulloreve për raportim dhe provizionim të humbjeve janë shfuqizuar dhe të dhënat aktuale të publikuara nuk reflektojnë koston reale të humbjeve. Rrjedhimisht, statistikat të cilat tregojnë normë të KJP-ve në fund të muajit gusht prej vetëm 2.6% nuk mund të jenë indikatorë të saktë. Reflektimi i vërtetë i kostove dhe KJP-

ve do të shihet në vitin 2021, pas kthimit gradual të rregulloreve në fuqi. Kjo do të ndikojë negativisht edhe në fitimin neto të bankave. Përkundër të gjitha vështirësive, sektori bankar mbetet i përkushtuar që të kontribuojë shumë në zgjidhjen e problemeve të shkaktuara nga COVID-19 duke ofruar qasje në financa për ekonomitë familjare dhe për bizneset. Njëkohësisht, reagimi i sektorit bankar ndaj krizës ekonomike do të jetë i balancuar duke ofruar fleksibilitet për klientët, por edhe duke ruajtur stabilitetin e sektorit bankar. Ky stabilitet do të vazhdojë t'i shërbejë rimëkëmbjes së gjithmbarshme ekonomike për mirëqenie më të mirë të shoqërisë në Kosovë. Vlen të theksohet që qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet të ndërmarrin sa më parë masat shtetërore ekonomike dhe fiskale, në mënyrë që ekonomia e Kosovës të ketë rimëkëmbje më të shpejtë.



LEHTËSIMI I PASOJAVE EKONOMIKE TË PANDEMISË PËRMES LEGJISLACIONIT

Pandemia e virusit SARS-CoV-2 është ngjarja më e rëndësishme dhe identifikuese e të gjitha gjeneratave që janë duke jetuar në këto vite. Nuk ka asnjë person në botë që nuk po përballët me një normale të re. Megjithatë, shumë shtete dhe kompani e kanë përdorur këtë situatë të re si katalizator për të ndryshuar mënyrën sesi punojnë dhe veprojnë. Përderisa shumë shtete kanë digjitalizuar shumë aspekte të jetës së tyre, ku qytetarët mund të votojnë, të qasen në shërbime publike, të marrin certifikata e diploma elektronike që janë më të sigurt sesa ato fizike, Kosova ende ngec në këtë aspekt. Kjo nuk është aspak e nevojshme, pasi Kosova është njëri prej shteteve me popullsinë më të re në botë. Një shoqëri ku gati çdokush ka telefona të mençur dhe prezencë në rrjete sociale, është normale që të priten shërbimet elektronike në secilin aspekt të jetës. Në Kosovë, baza për krijimin e bashkëpunimit dhe lidhjen e marrëveshjeve në formë elektronike mund të vendoset me një ligj: ligjin për identifikimin dhe nënshkrimin elektronik.

Tashmë e gjithë bota e di se rekomandimi kryesor për luftimin e pandemisë së COVID-19 është distanca fizike prej njëri-tjetrit. Por, kjo shumë është e vështirë nëse nuk ekziston një mënyrë e bashkëpunimit pa kontakt fizik. Historikisht njerëzit kanë bërë marrëveshje për shkëmbimin e të mirave që i kanë krijuar me punën e tyre. Thelbësore për këtë aktivitet është që të dihet identiteti i personave dhe kushtet e marrëveshjes; pra, të dihet se cilët persona po bëjnë marrëveshje, dhe për çka po lidhin marrëveshje. Kjo ekzekutohet lehtë kur personat janë afër dhe i shkruajnë këto gjëra në letër. Në distancë, përmes internetit kjo është e pamundur nëse nuk ka ligje që e rregullojnë procesin. Fatmirësisht, kjo është rregulluar shumë mirë në Bashkimin Evropian (EU) në vitin



PARTIN PRUTHI

Jurist

1999. Fatbardhësisht, edhe në Kosovë është miratuar Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike në vitin 2006, dhe ligji pasardhës në vitin 2012. Identifikimi dhe nënshkrimi elektronik i mundëson personave dhe kompanive që të lidhin marrëveshje kudo qofshin në botë, me të njëjtën siguri ligjore dhe siguri të informacionit mu sikur bëhet marrëveshja në letër. Gjithashtu, kjo e ngrit efikasitetin në aspekte tjera p.sh. dorëzimi i faturave, ngritja e integritetit të informatave dhe lehtësimi i arkivimit.

Fatkeqësisht, Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike është harruar dhe nuk është përdorur asnjëherë. Madje as aktet nënligjore të përcaktuara me ligj që të nxirren nuk janë hartuar. Si duket, në Kosovë, marrëveshjet fizike në letër janë konsideruar si mjaft të mira, dhe asnjëherë nuk ka pasur vullnet që të mendohet për diçka më mirë. Në anën tjetër, në BE është zëvendësuar direktiva e lartcekur para gjashtë vjetësh dhe ka filluar të diskutohet si të përmirësohet Rregullorja eIDAS.



... funksionimi i identifikimit dhe nënshkrimit elektronik në Kosovë do të ndihmonte ekonominë e Kosovës gjatë pandemisë, sidomos sektorin financiar...

Nuk është e vështirë që ajo që ekziston në BE të bëhet edhe në Kosovë dhe me anë të legjislacionit t'u ofrohet mundësia bizneseve të zhvillojnë dhe të ofrojnë shërbime të ndryshme elektronike. Nuk ka nevojë të shpiken ligjet, vetëm duhet të kopjohen ato të BE-së. Ashtu edhe jemi pajtuar si palë kontraktuese me EU-në në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Për momentin, ekziston një projektligj i cili e transpozon Rregulloren eIDAS dhe ai është dërguar në Kuvend. Çka nuk ekziston është vullneti i Kuvendit që ta miratojë atë sa më shpejtë, që t'u jepet mundësia Ministrive përkatëse ta zbatojnë atë. Përveç kësaj, edhe fondet për zbatimin e atij ligji do të vijnë nga Instrumenti i Ndihmës Para Aderimit (IPA).

Nuk ka aspak dyshim se funksionimi i identifikimit dhe nënshkrimit elektronik në Kosovë do të ndihmonte ekonominë e Kosovës gjatë pandemisë, sidomos sektorin financiar, i cili është tërësisht i bazuar në marrëveshje të cilat janë të shkruara në letër dhe të nënshkruara nga palët. As nuk ka dyshim lidhur me përmbajtjen e projektligjit të lartcekur dhe zbatimin e tij. I vetmi dyshim lidhet me qëllimet e deputetëve të Kuvendit, ku me tentimin e shumëfishtë për miratimin e Projektligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike është bërë e diskutueshme se a i kanë ata interesat e qytetarëve prioritet.





FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

TË ARRITURAT NË 2020

8,401

VENDE TË REJA PUNE

762



Bujqësi, pylltari
dhe peshkatari

1,410



Prodhim

2,829



Tregti me
shumicë e pakicë

785



Ndërtimtari

2,615




Shërbime

Parashikim i raportuar nga MVM-të

KREDI PËR GRATË NË BIZNES


12% e kredive të garantuara
janë për gratë ndërmarrëse



12%



TË ARRITURAT E FKGK-së DERI MË 31 TETOR 2020



A DO TË NGADHËNJEJË BUXHETI I KOSOVËS MBI KRIZËN EKONOMIKE TË SHKAKTUAR NGA COVID-19?

ekonomike dhe Për shkak të vonesave në formimin e qeverisë, buxheti i Kosovës për vitin 2020 ishte miratuar jashtë afateve të rregullta ligjore. Duke pasur parasysh krizën shëndetësore dhe ekonomike që pritej të shkaktohej nga COVID-19, buxheti u miratua me urgjencë në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo, miratimi i buxhetit nuk i zgjodhi problemet lidhur me krijimin e mundësive për qeverinë për një reagim të plotë ndaj tronditjes ekonomike dhe krizës sociale që po sillte COVID-19. Kjo ngase buxheti hartohet pothuajse një vit më herët dhe, në raste të caktuara, për akomodim të shpenzimeve të paplanifikuara nevojitet edhe përkrahja e Kuvendit të Kosovës. Konkretisht, në rast se do të duhej të bëhet transfer mbi 25% i një ndarjeje buxhetore, do të ishte e nevojshme të përfshihet edhe Kuvendi i Kosovës. Kufizim tjetër për sa i përket krijimit të hapësirës buxhetore për trajtimin e krizës ishte edhe përqindja shumë e lartë e buxhetit për investime kapitale që ishte vazhdim nga vitet e kaluara.

Përveç aspektit të shpenzimeve, vota e Kuvendit të Kosovës nevojitet edhe për rritje të deficitit buxhetor dhe hyrje në kredi të reja. Nevoja për rritje të deficitit buxhetor erdhi si pasojë e rënies së të hyrave, por edhe e rritjes së shpenzimeve, ngase qeveria miratoi një pako fiskale emergjente dhe një pako të dytë të quajtur "Pakoja e rimëkëmbjes ekonomike". Përderisa buxheti i ndarë për pakon emergjente ishte rreth 179 milionë euro, buxheti i ndarë për pakon e rimëkëmbjes shkon në 365 milionë euro, mirëpo nga kjo shumë do të paguhet edhe një pjesë e pagesave të parealizuar nga pakoja emergjente.

Kosova hyri në krizën e shkaktuar nga COVID-19 me një borxh publik mjaft të ulët, rreth 20 pikë përqindjeje më i ulët se borxhi i lejuar me ligj, dhe kjo



BERAT THAQI

Analist i politikave
Instituti GAP

lejonte hapësirë të konsiderueshme fiskale për adresim të krizës. Mirëpo, të gjitha këto masa të përmendura më lart, u pamundësuan si alternativë e shpejtë sepse koalicioni qeverisës pësoi votë mosbesimi në Kuvendin e Kosovës. Ndërsa pakoja emergjente u votua në qeveri, fillimi i votimit të kredive të reja apo rritja e deficitit u bënë pas zgjedhjes së qeverisë së re. Vendimi i qeverisë për zbatimin e pakos së rimëkëmbjes u mor vetëm nga mesi i muajit gusht, apo rreth pesë muaj më vonë pas fillimit të pandemisë në Kosovë.

Përderisa rishikimi i buxhetit u votua falë mbështetjes konstruktive edhe të partive opozitare, ende nuk kanë filluar së zbatuari një pjesë e masave për rimëkëmbje ekonomike, pjesë e projektligjit për rimëkëmbje, si dhe një pjesë e marrëveshjeve ndërkombëtare për kredi. Duke marrë parasysh se për miratimin e kredive ndërkombëtare nevojiten 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit, adresimi i plotë i krizës ekonomike nuk do të mund të bëhet pa një unitet politik në mes të

partive politike. Në rast të mosmiratimit të kredive, shpenzimet publike do të bien dhe kjo do të përshpejtojë edhe më tej rënien ekonomike. Në vitin 2020, Kosova pritet që t'i ketë shpenzimet më të ulëta publike si përqindje e Bruto Produktit Vendor (BPV).

Përveç rrezikut të rënies së shpenzimeve që mund të thellojnë rënien ekonomike, kategoria e investimeve kapitale si kategori e cila ndihmon në rritje më të shpejtë ekonomike, mund të ketë një rënie të theksuar këtë vit. Kjo ngase buxheti u miratua me vonesë dhe një pjesë e punimeve, veçanërisht në infrastrukturë që përbëjnë shumicën e investimeve kapitale, janë ndërprerë si pasojë e masave për parandalimin e COVID-19.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në pakon emergjente, qeveria me të drejtë kishte fokusuar masat për adresimin e krizës. Mirëpo, tashmë kur rregullat për ndihmën shtetërore drejtuar sektorit privat janë pothuajse të pezulluara në Kosovë dhe në botë, kjo situatë sjell edhe rreziqe të reja për menaxhimin e buxhetit. Rritja e madhe e subvencioneve si një nga kategoritë më pak të rregulluara ligjërisht, mund të krijojë hapësirë për abuzim të parase publike dhe pabarazi në garën ndërmjet kompanive të sektorit privat.

Me gjithë rreziqet dhe sfidat që ka sjellur COVID-19, ky moment paraqet edhe mundësi qoftë për shfrytëzim të buxhetit për transformim ekonomik të vendit, apo për realizim të qëllimeve shoqërore e kulturore. Kosova vazhdon ta ketë nivelin më të ulët të borxhit publik në rajon dhe kjo është një gjë e mirë. Mirëpo për shfrytëzim sa më të mirë të kësaj situatë dhe të hapësirës fiskale, nevojitet debat i vazhdueshëm politik dhe shoqëror në mes të grupeve të ndryshme shoqërore. Është e nevojshme që projektet publike dhe ndihma për sektorin privat të jenë të bazuara në prioritetet strategjike, kritere të qarta dhe transparente në mënyrë që të shmangët shpenzimi i parase publike për qëllime klienteliste. Në të kundërtën, Kosova do të përfundojë duke e rritur

borxhin publik dhe duke shpenzuar paratë e tatimpaguesve pa ndonjë rezultat.


Duke marrë parasysh brishtësinë e numrave të qeverisë aktuale, transparenca dhe përfshirja e aktorëve tjerë jashtë qeverisë (partitë opozitare ose shoqëria civile) në hartimin e kritereve për ndarjen e pakos së rimëkëmbjes ekonomike, do të mund të ndihmonte në arritjen e një uniteti politik dhe shoqëror. Miratimi i rishikimit të buxhetit dhe disa marrëveshjeve ndërkombëtare për kredi ishte një moment i mirë dhe konstruktiv në mes të partive politike parlamentare, dhe kjo qasje konstruktive është e domosdoshme edhe në muajt në vazhdim.



Përveç rrezikut të rënies së shpenzimeve që mund të thellojnë rënien ekonomike, kategoria e investimeve kapitale si kategori e cila ndihmon në rritje më të shpejtë ekonomike, mund të ketë një rënie të theksuar këtë vit.

Prandaj, çështja e shtruar në titullin e këtij shkrimi, nëse buxheti i Kosovës do të ndihmojë në zgjidhjen e krizës ekonomike, do të varet nga vullneti ynë si shoqëri, përfaqësuesit tanë politikë në qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës, bashkëpunimi dhe qeverisja e mirë.

PLATFORMA AGROSOFT DHE ROLI I SAJ NË MBËSHTETJEN E SEKTORIT TË BUJQËSISË



Bujqësia nuk është asgjë tjetër përpos një sektor i prodhimit të ushqimit me origjinë bimore dhe shtazore. Ndoshta ky do të mund të ishte një përshkrim sado i thjeshtë në mënyrë që të kuptohet rëndësia e këtij sektori, jo vetëm për shtetin tonë por në përgjithësi në aspektin global, ku prodhimi i ushqimit të mjaftueshëm është sfidë në vete krahasuar me rritjen e vazhdueshme të popullsisë globale.

Gjatë viteve të fundit të ne, ky sektor që konsiderohet shtyllë e rëndësishme e ekonomisë së një shteti, po përballët me sfida nga më të ndryshmet, qoftë nga produktet e importuara, nga mosfinancimi i mjaftueshëm krahasuar me nivelin e përkrahjes në vendet e BE-së ose edhe nga mungesa e fuqisë së kualifikuar punëtore. Zëvendësimi i produkteve bujqësore të importit me ato vendore do të vazhdojë të mbetet ndër sfidat më kryesore, aq më tepër që

në vazhdimësi Kosova do të bëhet treg akoma më i hapur. Bujqit vendorë do të vazhdojnë të konkurrojnë me fasulen që importohet nga vendet baltike apo hudhrën që vjen nga Kina e largët. Duke i marrë parasysh të gjitha këto, është shumë me rëndësi që ky sektor të jetë atraktiv për investime nga moshat më të reja, madje edhe nga zonat urbane.

Gjatë periudhës së pandemisë së COVID-19, jo të gjitha aktivitetet bujqësore janë prekur njësoj. Përderisa për kultivuesit e mjedrës ky ishte një vit i suksesshëm si rrjedhojë e çmimit të mirë në bursë dhe rritjes së kërkesës për konsum të frutave gjatë kësaj periudhe, nga ana tjetër bujqit që e kanë furnizuar zinxhirin e HoReCa-s kanë pasur vështirësi në plasimin e produkteve të tyre në treg. Në këtë kategori bëjnë pjesë sidomos prodhuesit e perimeve dhe blegtorët që janë marrë me majmëri të kafshëve.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore përmes përkrahjes nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) vazhdon ta ketë në fokus bujqësinë si prodhimtari parësor dhe përpunimin e produkteve bujqësore brenda zinxhirit të shtimit të vlerës. Pos garantimit të financimit bujqësor, FK GK-ja ka ideuar dhe zhvilluar edhe mundësi të tjera që do t'u mundësojnë institucioneve financiare të bëjnë analiza më të sakta dhe më të besueshme.

Në mënyrë që ta kemi të qartë sesi funksionon kjo platformë, e kemi marrë në intervistë z. Kastriot Këpuska që është agro-ekspert në FK GK.

FK GK: Z. Këpuska, a mund të na njoftoni më shumë rreth platformës AgroSoft që është vënë në funksion rishtazi?

KK: AgroSoft është një platformë dinamike e cila ka për qëllim t'u lehtësojë punën institucioneve financiare në mënyrë që të marrin vendime me vend gjatë analizës së kredive bujqësore, duke minimizuar asimetrinë e informacionit në mes të fermerit dhe institucionit financiar. Si e tillë, platforma mund të përdoret në pajisje të ndryshme siç janë: kompjuterët desktop, laptop ose telefonat e mençur (smartfon). Zhvillimi i saj u mundësua nga banka KfW, e cila ka ndihmuar në realizimin e kësaj platforme përmes asistencës teknike të dhënë në kuadër të Dritares Agro të FK GK-se.

Kjo platformë i merr të dhënat në kohë reale, pas përditësimit të vazhdueshëm nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Të dhënat e grumbulluara nga terreni përfshijnë rendimentin, çmimin e shitjes me pakicë dhe shumicë në rajone të ndryshme të vendit, fitimin nga një aktivitet bujqësor etj.; me këto të dhëna pastaj bëhet analiza dhe krijohen pasqyrat financiare, në bazë të së cilave institucioni financiar vendos për financimin e atij klienti.

Gjatë vizitës në MBPZHR takuam znj. Delvina Hana-Bakija, e cila na tregoi për bashkëpunimin ndërmjet kësaj ministrie dhe FK GK-së.

FK GK: Znj. Bakija, në çfarë niveli bashkëpunoni me FK GK-në dhe si keni ardhur deri te ky bashkëpunim?

DHB: Bashkëpunimi ka qene i natyrshëm, duke pasur parasysh edhe qëllimin e përbashkët që kemi për të nxitur sa më shumë financimin bujqësor. Ne si departament për analiza dhe statistika bujqësore i kemi ndihmuar pa ngurrim FK GK-së që t'i integrojë dhe përditësojë vazhdimisht të dhënat që ne i grumbullojmë nga terreni. Varësisht nga kërkesa e tyre, ne u kemi dhënë statistikën që ne i kemi në dispozicion, siç janë çmimet e kulturave bujqësore, rendimenti i tyre, kostoja e prodhimit, kostoja e investimit etj.

Vlen të theksohet që gjatë periudhës së pandemisë së COVID-19, jo të gjitha aktivitetet bujqësore janë prekur njësoj. Ndërkohë që për kultivuesit e mjedres ky ishte një vit i suksesshëm si rrjedhojë e çmimit të mirë në bursë dhe rritjes së kërkesës për konsum të frutave gjatë kësaj periudhe, nga ana tjetër bujqit që e kanë furnizuar zinxhirin e HoReCa-s kanë pasur vështirësi në plasimin e produkteve të tyre në treg. Në këtë kategori bëjnë pjesë sidomos prodhuesit e perimeve dhe blegtorët që janë marrë me majmëri të kafshëve.

Platforma AgroSoft, mes tjerash, do t'i ndihmojë në mënyrë të tërthortë edhe këta fermerë të prekur nga pandemia, duke iu krijuar mundësinë institucioneve financiare që të ndihen më të sigurt gjatë financimit të tyre duke u bazuar jo vetëm në situatën gjatë pandemisë, por duke u referuar edhe në të dhënat historike të ecurisë së çmimeve dhe rendimenteve të kulturave bujqësore.

HIT FLORES

NJË QENDËR GRUMBULLUESE NË MALET E SHARRIT

Hit-Flores është një kompani e cila merret me grumbullimin dhe përpunimin e bimëve mjekësore, kërpudhave dhe frutave të malit. Kompania gjithashtu merret me përpunimin dhe paketimin e çajit që mbledhet drejtpërdrejt nga Malet e Sharrit.

"Ne filluam biznesin tonë në vitin 2005, fillimisht me grumbullimin e frutave të malit dhe gradualisht duke u zgjeruar edhe në grumbullimin e bimëve mjekësore dhe kërpudhave. Qëllimi ynë kryesor është që përmes grumbullimit të frutave dhe bimëve mjekësore me cilësi të lartë nga malet e bukura të Sharrit, si dhe përmes klasifikimit dhe paketimit të duhur, të jemi të pranishëm në tregjet ndërkombëtare", thekson z. Arafat Bajrami, pronar i biznesit Hit Flores.

Aktualisht kompania është duke bashkëpunuar me më shumë se 4000 fermerë dhe me kompani të ndryshme

ndërkombëtare nga dhjetë shtete të Evropës. Kompania bashkëpunon me fermerët vendas nga rajoni i Dragashit, Shtërpçës, Brezovicës, Mitrovicës, Vushtrrisë, si dhe me fermerë nga veriu i Shqipërisë. Kompania punëson 28 punëtorë të përhershëm dhe 70-120 punëtorë stinorë sipas nevojës.

"Me zgjerimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të kompanisë, kuptuam që kishim nevojë për investime në zgjerim të objektit në mënyrë që aktiviteti ynë të mbështetet sa më mirë. Këtë investim e arritëm me kredinë që u garantua nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore", thekson z. Bajrami.

Përmes investimit të bërë, kompania arriti të krijojë hapësirë më të mirë për deponimin dhe konservimin e produkteve, duke i bërë ato të gatshme për plasim në tregjet vendore dhe ndërkombëtare.



Financimi përfiton nga mbështetja e Bashkimit Evropian në kuadër të Fondit për Garancimin e Kredive të krijuar sipas Rregulorës (EU) Nr 1207/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e Programit për Konkurrencë dhe Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014 -2020).



Mbështetja e këtij investimi është bërë përmes kredisë së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore së bashku me Programin COSME të Fondit Evropian për Investime, të cilët janë duke mbështetur qasjen në financa për NMVM-të në fazat e ndryshme të ciklit të jetës së tyre, si gjatë krijimit, zgjerimit ose transferimit të biznesit.

ARBËRIA GROUP PRODHUESE E UJIT NATYRAL MINERAL "UJË I ALPEVE"


Arbëria Group është kompani e cila merret me prodhimin e ujit natyral mineral "Ujë i Alpeve" dhe me prodhimin e lëngjeve të gazuara.

"Ishte viti 2010 kur themeluam fabrikën e Ujit të Alpeve me qëllim që të prodhojmë dhe sjellim ujë cilësor natyror nga burimi deri te sofa e konsumatorëve. Uji natyral i Alpeve buron nga thellësia e Alpeve në malet e Gollakut në fshatin Koliq, në një lartësi mbidetare mbi 1200 metra, nga një burim i lashtë uji natyral mineral, i njohur si ujë me cilësi të lartë", thekson z. Afrim Osmani, pronar i biznesit.

Aktualisht, kompania është duke bashkëpunuar me më shumë se 1500 kompani vendore, hipermarkete dhe supermarkete vendore, si dhe shitës me pakicë.

"Që nga 2010-ta, kompania jonë ka arritur që të zgjerohet, duke shtuar linjat prodhuese dhe numrin e të punësuarve, dhe të njihet si emër në mesin e konsumatorëve. Për të ofruar një cilësi të lartë, ne e ambalazhojmë ujin me teknologji moderne evropiane të certifikuar sipas standardeve evropiane, teknologji e cila mundëson që Uji i Alpeve t'i ruajë të gjitha vetitë natyrale nga burimi. Por, përpos teknologjisë së avancuar që kemi, për të realizuar planifikimet dhe për të qenë konkurrues në treg, ne kishim nevojë të investojmë edhe për kapitalin punues. Këtë investim e arritëm me kredinë që u garantua nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore", thekson z. Osmani.

Përmes investimit të bërë, kompania arriti të realizojë prodhimin si dhe shitjet e planifikuara, gjë që njëkohësisht rezultoi me zhvillim të biznesit.



Financimi përfiton nga mbështetja e Bashkimit Evropian në kuadër të Fondit për Garantimin e Kredive të krijuar sipas Rregullores (EU) Nr 1287/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e Programit për Konkurrencë dhe Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014 -2020).



Mbështetja e këtij investimi është bërë përmes kredisë së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore së bashku me Programin COSME të Fondit Evropian për Investime, të cilët janë duke mbështetur qasjen në financa për NMVM-të në fazat e ndryshme të ciklit të jetës së tyre, si gjatë krijimit, zgjerimit ose transferimit të biznesit.

FKGK DHE MFK SË BASHKU PËR TË MBËSHTETUR INVESTIMET NË ENERGJINË E RIPËRTËRISHME SOLARE

Janar 2020 - Fondacioni Kosovar i Mileniumit (MFK) së bashku me Korporatën e Sfidave të Mileniumit (MCC) dhe Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) organizuan një sesion informues ekzekutiv për komunitetin e donatorëve, organizatat ndërkombëtare zhvillimore dhe financiare, në mënyrë që të ofrojnë më shumë informata mbi projektin në vlerë prej 5 milionë dollarë të MFK-së për mbështetjen e prodhuesve të pavarur të energjisë së ripërtëritshme (IPP).



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA FINANCIARE PËR RITJE TË KAPITALIT GARANTUES TË FKGK-SË

Prill 2020 – Ministri në detyrë i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi dhe drejtori i Zyrës së KfW-së për Kosovë, Rene Eschemann, nënshkruan marrëveshjen financiare për rritje të kapitalit garantues të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në vlerë prej 6.5 milionë euro me fokus në mbështetjen e kreditimit për sektorin e agrobiznesit.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR NDIHMË NDËRMJET MF-SË DHE FKGK-SË

Shtator 2020 - Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, dhe Drejtori Menaxhues i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Besnik Berisha, nënshkruan marrëveshjen për ndihmë në vlerë prej rreth 22.3 milionë euro. Me këtë marrëveshje, e cila vjen si rezultat i marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar.



MFK, FKGK DHE MF NËNSHKRUAJNË LETRËN E QËLLIMIT

Shtator 2020 - Fondacioni Kosovar i Mileniumit (MFK), Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe Ministria e Financave (MF) nënshkruan letrën e qëllimit për fillimin e financimit tregtar me vlerë deri në 25 milionë euro për projekte të energjisë së ripërtëritshme dhe efikasitet të energjisë. Palët nënshkruan letrën e qëllimit në praninë e Korporatës së Sfidave të Mileniumit (MCC) dhe delegacionit të Korporatës Amerikane Financiare për Zhvillim Ndërkombëtar (DFC), të cilët ishin për vizitë në Kosovë për avancimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA FINANCIARE PËR RITJE TË KAPITALIT GARANTUES PËR FKGK

Nëntor 2020 – Nënshkruhet marrëveshja financiare për rritje të kapitalit garantues të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Drejtori i Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) për Evropën Juglindore dhe Turqinë, Dr. Klaus Müller, dhe drejtori menaxhues i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Besnik Berisha, kanë nënshkruar marrëveshjen financiare për rritje të kapitalit garantues të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në vlerë prej 5 milionë euro. Kjo mbështetje është duke u ofruar nga qeveria gjermane për fuqizimin e huadhënies për sektorin e biznesit në përgjithësi, për të evituar pasojat e krizës si rrjedhojë e pandemisë së COVID-19. Linjat garantuese të cilat janë financuar në tërësi nga qeveria gjermane, me ndërmjetësim nga KfW, tashmë mbështeten me kapitalin prej 18.5 milionë euro.



IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT TË BANKËS BOTËRORE PËR FUQIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR NË KOSOVË

Dhjetor 2020 - Si rezultat i marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar, kapitali i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore u rrit në vlerë prej 21.4 milionë euro. Përmes Projektit për Fuqizimin e Sektorit Financiar, Banka Botërore synon të mbështesë rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës, përmes mbështetjes së qasjes në financa duke targetuar krijimin e dritareve garantuese për segmentet e caktuara të tregut, siç janë ato për gratë në biznes, ndërmarrësit e rinj dhe sektorin e prodhimit si dhe synon të avancojë kapacitetet financiare dhe teknike të FKGK-së përmes sigurimit të asistencës teknike. Vlera totale e marrëveshjes për ndihmë duke përfshirë edhe asistencën teknike është në vlerë prej rreth 22.3 milionë euro. Përmes këtij kapitali, FKGK do të fuqizojë rolin e saj në përpjekjet për luftimin e efekteve negative të shkaktuara nga pandemia e COVID-19 në kuadër të Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike.




PAKOJA E RIMËKËMBJES EKONOMIKE

Dhjetor 2020 – Ndërkohë që pandemia e COVID-19 po bënte të vetën, NMVMtë filluan të ndienin efektet e saj në çdo aspekt. Që në fillim, FKGK-ja mori përgjegjësinë për të ndihmuar sektorin e NMVM-ve me krijimin e produkteve garantuese të cilat do t'i përgjigjeshin vazhdimësisë së huadhënies për NMVMtë, në mënyrë që të përmbushej nevoja për likuiditet dhe financim të investimeve. Në këtë drejtim, FKGK-ja dizajnoi produkte për sektorë dhe segmente të veçanta përpiloi marrëveshjet e garancisë, modifikoi sistemin informativ të menaxhimit dhe mbajti të informuar institucionet financiare partnere lidhur me risitë që do të sillte Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike. Zbatimi i kësaj iniciative të përbashkët me Qeverinë e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë, do të jetë i mundur, tanimë pas miratimit të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike në Kuvendin e Kosovës dhe ratifikimit të Ligjit për rimëkëmbje ekonomike nga u.d. Presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë FKGK lansoi Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike e cila do të mbështesë kreditimin në sektorët siç janë prodhimtaria, shërbimet, bujqësia, tregtia, me fokus të veçantë për gratë në biznes, start-up-ët, si dhe investimet në efikasitet të energjisë.



FKGK PREZANTON ROLIN E TIJ INSTITUCIONAL NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT

Shkurt 2020 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore prezanton rolin e tij institucional në zhvillimin ekonomik të vendit, me theks të veçantë të përkrahja e agrobizneseve vendore. Gjatë prezantimit para anëtarëve të Shoqatës së Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve të Kosovës (PePeKo) dhe të Shoqatës Nacionale të Mjedorave u diskutua rreth qasjes sa më të lehtë në financa që duhet të jetë në dispozicion për agrobizneset vendore të këtij nën-sektori.



FKGK MERR PJESË NË FORUMIN VIRTUAL TË ORGANIZUAR NGA AMCHAM

Prill 2020 - Drejtori Menaxhues i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, z. Besnik Berisha mori pjesë në forumin virtual të organizuar nga AmCham me temën "Roli i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në trajtimin e ndikimit të COVID-19".

Në këtë panel z. Berisha njoftoi pjesëmarrësit për veprimtarinë aktuale të FKGK-së, si dhe për masat që po ndërmerren nga FKGK-ja, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë, për të mbështetur NMVM-të dhe institucionet partnere financiare gjatë pandemisë së COVID-19.



FKGK ORGANIZON TAKIMIN KOORDINUES ME DONATORËT DHE PARTNERËT E VET

Maj 2020 - Informimi rreth iniciativave dhe zhvillimeve, koordinimi ndërmjet tyre për krijimin e mundësive të reja për të ndihmuar NMVM-të për të tejkaluar situatën e shkaktuar nga pandemia përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, ishin disa nga diskutimet e zhvilluara në këtë takim. Në takim morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Transfereve si dhe përfaqësues të donatorëve ndërkombëtarë, siç janë: KfW, Zyra e USAID-it në Kosovë, Sida, Banka Botërore, Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (EBRD), Banka Evropiane për Investime (EIB), Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Ambasada e Japonisë në Kosovë.



LANSOHET PLATFORMA AGROSOFT NGA FKGK

Tetor 2020 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Shoqatën e Bankave të Kosovës (SHBK), lansuan platformën AgroSoft, projekt ky i mbështetur nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Platforma virtuale AgroSoft do t'i ndihmojë institucionet financiare për analizë sa më të saktë gjatë financimit bujqësor. Kjo platformë që është e lehtë për t'u përdorur, dinamike dhe e qasshme nga pajisje të ndryshme elektronike (desktop, laptop, tablet apo smartfon), si dhe e përditësuar nga MBPZHR-ja me të dhënat më të reja, do t'u mundësojë institucioneve financiare dhe palëve tjera relevante që të ngushtojnë hendekun e asimetrisë së informacionit ndërmjet fermerit, institucionit financiar dhe tregut.



FKGK PJESË E EDICIONIT TË TRETË TË JAVËS SË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË KOSOVËS

Tetor 2020 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, mori pjesë në panelin virtual me temën "Rimëkëmbja ekonomike nga COVID-19 përmes energjisë së pastër". Gjatë diskutimit në panel, z. Berisha theksoi se Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike planifikon mbështetjen e financimit të projekteve me fokus të veçantë në sektorin e energjisë së ripërtëritshme-solare dhe të efikasitë të energjisë.



TRAJNIMI PËR NGRITJE TË NJOHURIVE INSTITUCIONALE PËR ER DHE EE




Tetor 2020 – Punonjësit e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore morën pjesë në trajnimin dyditor për energji të ripërtëritshme dhe efikasitet të energjisë, që u mbajt nga ekspertët e Financial Markets International Inc.

Ky trajnim, i cili është pjesë e një prej tri ndërhyrjeve kyçe të marrëveshjes së lidhur ndërmjet MFK-së dhe FKGK-së që ka për qëllim të krijojë një mjedis


më të favorshëm për financimin e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë, u fokusua te mbështetja e FKGK-së për zhvillimin e kapaciteteve institucionale lidhur me ngritjen e njohurive financiare për tregun e energjisë solare, si dhe për krijimin e një dritareje garantuese për financimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme solare dhe investimeve që rritin efikasitetin e energjisë.

TRAJNIMI PËR PËRDORIMIN E PLATFORMËS AGROSOFT

Tetor 2020 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti trajnimet e para virtuale rreth përdorimit të platformës AgroSoft me stafin e përzgjedhur të bankave partnere. Përpos garancive kreditore, përmes platformës AgroSoft, FKGK-ja ndihmon qasjen më të lehtë në financa për fermerët dhe agrobizneset vendore, duke përkrahur një vendimarrje sa më të lehtë dhe sa më të besueshme për kreditim.



FKGK PJESË E KONVENTËS VJETORE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS 2020, "BANKIMI NË KOHËN E COVID-19"




Dhjetor 2020 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mori pjesë në panelin virtual me "Sfidat dhe qëndrueshmëria e Bankave në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19: Rimëkëmbja dhe ndryshimet e pritshme në sektorin bankar". Në këtë panel z. Berisha njoftoi pjesëmarrësit për veprimtarinë aktuale të FKGK-së si dhe masat që është duke i ndërmarrë FKGK-ja, në bashkëpunim me qeverinë e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtar, për të mbështetur NMVM-të dhe institucionet partnere financiare gjatë pandemisë së COVID-19.

Gjatë diskutimit në panel, z. Berisha njoftoi pjesëmarrësit lidhur me dritaret e reja si dhe lehtësitë e ofruara për sektorët dhe segmentet më pak të shërbyera, siç janë: bujqësia, gratë në biznes dhe bizneset start-up, duke inkurajuar institucionet partnere financiare që këtyre sektorëve dhe segmenteve t'u mundësohet qasja në financa, gjithnjë duke u siguruar që të mos ketë rritje të detyrimeve në nivelin që do të ishte mbingarkesë për përfituesit përfundimtarë.

VENDNDODHJA E RE E FKGK-SË

Qershor 2020 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore zhvendoset në zyrat e reja. Duke u bazuar në parimin e përgjegjësisë sociale, Fondi siguron që punonjësit të kenë në dispozicion hapësirë adekuate dhe të përshtatshme me të gjitha pajisjet dhe shërbimet e nevojshme për një mjedis më të mirë të punës.





FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Adresa:

Njazi Alishani Nr. 5,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 225 600
info@fondikgk.org

www.fondikgk.org